

PARADOKSI I MODERNITETIT NË RAPORTE GJINORE

TEMA PËR TITULLIN:
MASTER I FILOZOFISË

NGA:

NJOMZA AZEMI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I FILOZOFISË
PRISHTINË

QERSHOR, 2022

REZYME

"PARADOKSI I MODERNITETIT NË RAPORTE"

Mentori:

Prof. Ass. Dr: HASNIJE ILAZI

Ky punim paraqet seksualitetin njerëzor i cili është një nga burimet kryesore të energjisë jetësore që nxit sjelljen njerëzore. Kjo energji jetësore, sipas Freud është tashmë e pranishme që në javët e para të jetës sonë, që do të thotë se aspekti ynë seksual nuk ka lindur në adoleshencë, siç menduan shumë studiues të kohës së tij. Seksualiteti dhe dashuria janë parë si shfaqje dhe përjetime të ndryshme mes gjinive, dhe kjo ka mundësuar paradoksin e modernitetit në raporte gjinore. Foucault argumentoi se koncepti i '*seksualitetit*' është një nocion veçanërisht modern që kombinon dëshirën e brendshme dhe sjelljen e jashtme; ajo shoqërohet me forma të reja dijeje dhe fuqie, të cilat i klasifikojnë njerëzit në termat '*normal*' dhe '*patologjikë*'. Në anën tjetër, është mjaft i vlefshëm mendimi filozofik i Beauvoir për ndryshueshmërin gjinore në përjetimin e dashurisë dhe mundësin e ekzistimit të dashurisë autentike, përkundër Sartre i cili kundërshtone mundësinë për një lloj të tillë dashurie.

Për nga struktura ky punim është i ndarë në katër kapituj

Strukturalisht, ky punim është i organizuar mbrenda katër kapitujve, ku secili prej tyre përmban disa nënkapituj ku elaborohen nëntema brenda kapitullit përkatës. Punimi provon të elaboroj *Paradoksin e modernitetit në raporte gjinore*.

Në kapitullin e parë: Do të trajtohet konceptualizimi i paradoksit të modernitetit në raporte gjinore, ndyshimet dhe ndikimet që ka pasur ardhja e modernitetit dhe rrënjosja e mendimeve paramoderne sidomos në mënyrën sesi janë parë dallimet apo ngjashmëritë gjinore në këtë periudhë kohore. Gjithashtu, do të shqyrtohen dallimet e konceptualizimit të seksit dhe gjinisë se si janë përceptuar nga shoqëria paramoderne dhe ajo moderne.

Në kapitullin e dytë: do të trajtohet koncepti i seksit dhe seksualitetit, pikëpamjet e ndryshme të përkufizimit të seksit dhe seksualitetit. Rëndësia e këtyre dy koncepteve, dhe çrrënjosja e mendimeve paramoderne përgjatë zhvillimit të shkencës dhe shoqërisë. Një rëndësi të veçantë në këtë kapitull e ka Freud me teorinë e tij të seksualitetit, në anën tjetër analiza e thellë e Simone de Beauvoir në librin e saj *Seksi i Dytë*, dhe infomacioni i vyer që ajo sjellë me anë të këtij libri në lidhje me dashurinë, llojet e saj, mundësinë e ekzistencës së saj si dashuri autentike e cila respekton të drejtën e tjetri (partnerin) në radhë të parë e pastaj të vetës si dhe kundër argumentin e Sartre mbi mendimin e Beauvoir në lidhje me dashurinë autentike.

Në kapitullin e tretë: do të trajtohet raporti gjinorë ku përfshinë dashurinë si ekzistencë, teorinë e dashurisë së Stenberg dhe dinamikat evolutive të pikëpamjes së dashurisë. Nga ky kapitull do arrijm të kuptojmë për rëndësinë ekzistenciale që ka dashuria në jetën njerëzore, si përceptohet ajo nga pikëpamja mashkullore dhe nga ajo femërore, cilat janë pikat e përbashkëta që çojn në krijimin e dashurisë tek të dy gjinitë. Dhe si ka ndikuar evoluimi i jetës njerëzore në ndyshueshmërinë e pikëpamjes së dashurisë tani në dallim nga kohët e vjetra.

Në kapitullin e katërt: do të trajtohen dallimet gjinore në zhvillimin emocional në marrëdhënie dashurie, dallimi gjinor në përjetimin e ndarjes nga partneri si dhe do të jepet një shpjegim se si truri e pëcepton dashurinë. Nga këto që do të elaborohen në këtë kapitull, mund të shohim se dashuria për mendjen njerëzore nuk është vetëm një emocion me intensitete të ndryshme por shumë më tepër se kaq, mund të jetë një varësi, një motiv, një çrregullim, një nevojë për tu larguar nga ankthi ekzistencial, apo një mënyrë e vetë jetës për të vazhduar vazhdimësinë e saj.